

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
DREJTORINË RAJONALE RRUGORE JUGORE GJIROKASTËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Drejtorinë Rajonale Rrugore Jugore, Gjirokastrë**, me objekt: “Mbi Zbatimin e Ligjshmërisë, Rregullshmërisë të Aktivitetit Ekonomiko-Financiar dhe Vlerësues”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.07.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 161, datë 11.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 743/10, datë 11.12.2014, i ka rekomanduar z. Dhimiter Nasi Drejtor i DRRRJ Gjirokastrë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE:

1-Gjetjet nga auditimi i zbatimit të detyrave të lëna në auditimet e mëparshme të KLSH-së me nr. 61/9, datë 14.8.2007.

1.1 Gjetja nga auditimi: Nga auditimi rezulton se detyrimet e lëna për zbatim nga KLSH me shkresën nr. 61/9, datë 14.8.2007 janë evidentuar në kontabilitet, janë njoftuar subjektet për shlyerjen e detyrimit dhe janë bërë kërkesë padi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në prokurimet me fonde publike për të gjithë operatorët ekonomik, por nuk janë depozituar në gjykatë dhe deri më datë 29.8.2014 vlera prej 11,485,935 lekë, për 11 subjekte nuk është arkëtuar.

1.2 Niveli i prioritetit. Vlera e mësipërme në shumën 11,485,935 lekë ka nivel të lartë prioriteti dhe është me ndikim të lartë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

1.3 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Jugore Gjirokastrë të ndërmarrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 11,485,935 lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimin, për subjektet e mëposhtme:

- Operatorin “A...” sh.p.k Përmet për vlerën 153.814 lekë, për diferencë të volumeve të punës ndërmjet librezës së masave dhe situacionit, për përdorim të fondit rezervë pa miratim të projektuesit dhe pa firmosur nga specialisti i degës teknike.
- Operatorin “I...” sh.p.k Tepelenë për vlerën 111.150 lekë, për përdorim të fondit rezervë pa miratim të projektuesit dhe pa firmosur nga specialisti i degës teknike.
- Operatorin “T...” sh.p.k Përmet për vlerën 153.890 lekë, për diferencë të volumeve të punës ndërmjet librezës së masave dhe situacionit, për përdorim të fondit rezervë pa miratim të projektuesit dhe pa firmosur nga specialisti i degës teknike.
- Personi fizik “T.S.” Përmet për vlerën 746.640 lekë, për kontratë shtesë shërbimi pa përshkruar nevojën për këtë shërbim, pa preventiv, pa firmosur nga specialisti i degës teknike.
- Personi fizik “A.P.” Përmet për vlerën 152.950 lekë, për përfitim të padrejtë të TVSH - së, nga mos vendosja në kushte të barabarta të ofertës të këtij subjekti fizik me ofertat e subjekteve juridikë gjatë vlerësimit të ofertave nga komisioni i vlerësimit të ofertave.
- Operatorin “D...” sh.p.k Skrapar për vlerën 139.612 lekë, për përdorim të fondit rezervë pa miratim të projektuesit dhe pa firmosur nga specialisti i degës teknike.
- Operatorin “J...” sh.p.k Përmet për vlerën 70.869 lekë, për përfshirje në shpenzimet e drejtpërdrejta të zërave të punës që janë objekt i legjislacionit fiskal, si tatim fitimi, etj.
- Personi fizik “K.N.” Përmet për vlerën 734.611 lekë, për përfitim të padrejtë të TVSH – së, nga mos vendosja në kushte të barabarta të ofertës të këtij subjekti fizik me ofertat e subjekteve juridikë gjatë vlerësimit të ofertave nga komisioni i vlerësimit të ofertave, mos zbatim i çmimeve të kontratës bazë, për volumet e punës të kryera në shtesën e kontratës.
- Operatorin “G...” sh.p.k Tepelenë për vlerën 57.816 lekë, për diferencë të volumeve të punës ndërmjet librezës së masave dhe situacionit të punimeve.

-Operatorin "E...B..." sh.p.k Sarandë për vlerën 3.150.963 lekë, përfitim të pa drejtë të TVSH-së së pajisjeve.

-Operatorin "Gj..." sh.p.k Fier për vlerën 6.013.620 lekë, për përlogaritje të gabuara të volumeve të punës në librezën e masave me ato të pasqyruara në situacionin përfundimtar të punimeve, diferencë ndërmjet situacionit dhe punimeve të kryera në fakt dhe diferencë ndërmjet projektit dhe librezës së masave.

Menjëherë

2. Gjetjet nga auditimi aktual i KLSH-së me nr. 743/2, datë 4.8.2014.

1.1 Gjetja nga auditimi.

Anëtarët e komisionit të inventarizimit nuk kanë plotësuar deklaratën për konflikt interesi; para fillimit të inventarit, nuk është mbajtur procesverbal me përgjegjësin material; inventarizimi i vlerave materiale dhe aktiveve është realizuar tej afatit të përcaktuar në urdhrin Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve; në fletët e inventarit nuk ka nënshkruar personi që ka në ngarkim vlerat materiale por vetëm komisioni i inventarizimit; nuk është përpiluar relacioni për Drejtorinë e Përgjithshme të Rugëve mbi rezultatet e inventarizimit; nuk është kërkuar miratimi i procedurave të realizuara, nuk ka miratim nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe tjetërsimin e vlerave materiale dhe aktiveve në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" kreu IV, paragrafi 82-112.

1.2 Rekomandimi.

Drejtoria Rajonale Jugore Gjirokastrë të përgatisë dhe të miratojë një sistem të rregullave specifike të procedurave për administrimin ruajtjen, inventarizimin, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike.

Menjëherë

2.1 Gjetja nga auditimi.

Nga KVO nuk është mbajtur procesverbali i vlerësimit të procedurës, ofertave të paraqitura për pjesëmarrësit dhe vlerësimin e të gjitha dokumenteve e paraqitura prej tyre ku të pasqyrohen operatorët e kualifikuar dhe ata të skualifikuar, sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, pika 4, germa i: "*Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbalin e prokurimit*".

2.2 Rekomandimi.

Nga KVO duhet të mbahet procesverbali i vlerësimit të procedurës, ofertave të paraqitura për pjesëmarrësit dhe vlerësimin e të gjitha dokumenteve të paraqitura prej tyre ku të pasqyrohen operatorët e kualifikuar dhe ata të skualifikuar duke regjistruar çdo hap të procedurës së prokurimit.

Në vijimësi

3.1 Gjetja nga auditimi.

Në të gjitha kontratat e furnizimit me karburant nuk janë ngritur komisione dhe nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim të mallit sipas kontratës dhe kërkesave të VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, "*Për rregullat e prokurimit publik*" kreu VIII, pika 2/b, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", UMF nr. 33, datë 11.7.2013, "*Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*", UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", pika 42,54,

3.2 Rekomandimi.

Nga autoriteti kontraktor për të gjitha kontratat e furnizimit me mallra të ngrihen komisione dhe të hartohen procesverbale për marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara për t'u siguruar për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe dokumentacionit shoqërues sipas kushteve të kontratave dhe në përfundim të kontratës të përgatitë një raport përmbljedhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.

Në vijimësi

4.1 Gjetja nga auditimi.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave, dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, situacionet mujore, librezat e masave, aktet e kontrollit dhe ditarin e punimeve konstatohet se:

1-Nuk ka patur një korrespondencë të rregullt bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktor, mbikëqyrësit të punimeve dhe operatorëve ekonomik në zbatimin e kontratave të shërbimit.

2-Për situacionet e paraqitura nga operatorët, në shumë raste nuk janë kryer kontrole nga mbikëqyrësi dhe nuk ka dokumente shoqëruese për të vërtetuar saktësinë dhe vërtetësinë e tyre.

3-Janë konstatuar mangësi në kontrollin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të punës dhe shërbimeve lidhur me zbatimin e kontratave si:

a- Nga Kontraktori i shërbimeve nuk janë kryer inspektime dhe prova 1 herë në javë (për rrugë kombëtare të asfaltuara) dhe nuk janë dorëzuar raportet e inspektimit të punimeve një herë në dy javë (një të hënë po e një jo), pasi siç përcaktohet në kontratat në kapitullin A. 3 Inspektimet dhe Provat si dhe A. 8 Detyrat Administrative të Kontraktorit, “...Kontraktori do të kryejë inspektime ditore nga e hëna në të dielë mbi nivelin e shërbimit në rrjetin e rrugëve që përfshihen në kontratë lidhur me gjithë aspektet që mund të vlerësohen me metoda të thjeshta... Çdo inspektim duhet të dokumentohet nga një raport i shkurtër që përfshin informacion sipas A.8.1..”.

b- Në disa dosje teknike nuk rezultojnë të jetë kryer asnjë inspektim informal nga ana e kontraktorit dhe mbikëqyrësve të punimeve mbi Nivelet e Cilësisë së Shërbimit duke mos u përmbushur në këtë mënyrë edhe detyra kryesore nga ana e Menaxherit të Projektit ajo e kontrollit të projektit në tërësi sipas kushteve të kontratës si dhe detyrimeve ligjore si mbikëqyrës i punimeve.

c- Nga Kontraktori i shërbimeve nuk është krijuar Njësia e Vetë-Kontrollit sipas kontratave, kapitullit A. 3, paragrafi i katërt i kushteve të kontratës sipas të cilët përcaktohet se: “Kontraktori do vendosë, brenda strukturës së tij organizative, një Njësi Vetë-Kontrolli të veçantë të plotësuar me personel të kualifikuar, detyra e të cilit është të monitorojë dhe mbështesë verifikimin e shkallës së përputhjes me Nivelet e Cilësisë së Shërbimit. Njësia e Vetë-Kontrollit gjithashtu do kryejë ose organizojë prova dhe matje; përgatisë, paraqesë dhe dorëzojë tek Menaxheri i Rrugës gjithë informacionin me qëllim krijimin e dokumentacionit të përcaktuar në Specifikimet dhe menaxhimin dhe mirëmbajtjen efektive të rrugëve. Njësia e vetë-kontrollit do kryejë gjithashtu ose monitorojë, në bashkëpunim të ngushtë me Menaxherin e Projektit, verifikimet mbi Nivelet e Cilësisë së Shërbimit.”

d- Nga autoriteti kontraktor janë likuiduar situacione për punë të pakryera të cilat nuk rezultojnë në dokumentacionin teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, librezat e masave, aktet e kontrollit dhe ditarin e punimeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratat e hartuara, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinin e Punimeve të Ndërtimit”, dhe konkretisht neni 7, UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu I, pika 1, pikat 3.2 dhe 3.3, ku përkatësisht përcaktohet se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion”.

4.2 Rekomandimi.

a-Nga Drejtoria Rajonale Jugore Gjirokastrë të kryhen inspektime dhe prova për rrugët kombëtare të asfaltuara mbi nivelin e shërbimit në rrjetin e rrugëve që përfshihen në kontratë dhe të shoqërohen me raportet e inspektimit të punimeve siç përcaktohet te Detyrat Administrative të Kontraktorit në kontratat tip të hartuara.

Në vijimësi

b-Nga Drejtoria Rajonale Jugore Gjirokastrë dhe mbikëqyrësve të punimeve të kryhet inspektim formal mbi Nivelet e Cilësisë së Shërbimit duke përmbushur detyrën kryesore të Menaxherit të Projektit ajo e kontrollit të projektit në tërësi sipas kushteve të kontratës dhe detyrimeve ligjore si mbikëqyrës i punimeve.

Në vijimësi

c- Drejtoria Rajonale Jugore Gjirokastrë të krijojë, brenda strukturës së saj organizative, Njësi Vetë-Kontrolli të veçantë me personel të kualifikuar, e cila të monitorojë dhe mbështesë verifikimin e shkallës së përputhjes me Nivelet e Cilësisë së Shërbimit, të kryejë ose organizojë prova dhe matje, të përgatisë, paraqesë dhe dorëzojë gjithë informacionin me qëllim krijimin e dokumentacionit të përcaktuar në specifikimet mbi menaxhimin dhe mirëmbajtjen efektive të rrugëve, në bashkëpunim të ngushtë me Menaxherin e Projektit.

Në vijimësi

d- Drejtoria Rajonale Jugore Gjirokastrë të kërkojë dhe likujdojë situacione mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare për punë të kryera, të cilat rezultojnë në dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, librezat e masave, aktet e kontrollit dhe ditarin e punimeve mbi bazën e volumeve të llogaritura dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualët teknike të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në vijimësi

5.1 Gjetja nga auditimi.

a-Në hartimin e preventivave nga komisioni; nuk ka gjurmë ku të jenë kryer inventarizimet e rrugëve për të cilat hartohet preventivi për çdo aks rrugor e cila duhet të përmbajë: projektin e zbatimit, inventarin e rrugës të përditësuar duke përfshirë të gjitha detajet: parametrat e rrugëve, nivelin e shtresave dhe nënshtresave, gjatësitë e kanaleve, tumbinove, urave, trafik ndarëseve, mureve mbajtës apo pritës, mbikalimeve, nënkalimeve, inventarët e sinjalistikës rrugore, të ndriçimit rrugor, të zonave të gjelbra dhe pemëve të mbjella, të trotuareve, si dhe çdo detaj tjetër të përfshirë në rrugët.

b- Nga Drejtoria Rajonale Jugore Gjirokastrë të bëhet një klasifikim i rrugëve në kategori dhe kriteret përkatëse për çdo kategori që duhet të plotësohen për të arritur parametrat e “performancës” pasi jo të gjitha rrugët mund të plotësojnë parametra të njëjtë për kategori të ndryshme.

5.2 Rekomandimi.

a-nga Drejtoria Rajonale Jugore Gjirokastrë para hartimit të preventivave të kryhen inventarizimet e rrugëve për çdo aks rrugor ku të përmbajnë: projektin e zbatimit, inventarin e rrugës të përditësuar duke përfshirë të gjitha detajet: parametrat e rrugëve, nivelin e shtresave dhe nënshtresave, gjatësitë e kanaleve, tumbinove, urave, trafik ndarëseve, mureve mbajtës apo pritës, mbikalimeve, nënkalimeve, inventarët e sinjalistikës rrugore, të ndriçimit rrugor, të zonave të gjelbra dhe pemëve të mbjella, të trotuareve, si dhe çdo detaj tjetër të përfshirë në rrugët.

Në vijimësi

b-Të kryhet një klasifikim i rrugëve për gjendjen e tyre, pasi para se të kërkohej “*performanca*” në mirëmbajtjen e tyre duhet të përcaktohen parametrat që duhet të plotësojë rruga, pasi jo të gjitha rrugët janë në parametra të njëjtë për të përfutur këtë lloj shërbimi, në mënyrë që zërat e punimeve dhe shërbimeve të jenë të matshëm, të monitorueshëm dhe të kontrollueshëm në tërësinë e tyre.

Në vijimësi

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë, administrativë e përmbartimorë në vlerën **12,041,480** lekë si më poshtë për:

1.1 Gjetja nga auditimi.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave për furnizimin me karburant rezulton se:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Blerje karburant 2013*”, nga llogaritja e furnizimit të likuiduar për subjektin “*E... D...Albania*” sh.a. nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS datën 10 qershor 2013 si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar prej 1,921,492 lekë për sasinë e gazoilit D1 prej 10,990 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 172.20 lekë/litri që është 1,892,478 lekë duke sjellë një pagesë tepër prej 29,014 lekë

-Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar për subjektin “*E...D...Albania*” sh.a. sipas kontratës nr. 492, datë 4.9.2013 rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar në çmimit referuar bursës REUTERS të datës 5 Qershor 2013. Si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar prej 4,079,215 lekë për sasinë e gazoilit D1 prej 21,590

litra, është më e lartë se ajo e llogaritur me çmimin 179.60 lekë/litri që është 3,877,564 lekë duke sjellë një pagesë tepër prej 201,651 lekë.

-Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar për subjektin “E...D...Albania” sh.a. sipas kontratës shtesë datë 16.4.2014 rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS datën 5 qershor 2013 si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar prej 815,972 lekë për sasinë e gazoilut D1 prej 4,325 litra është më e larta se ajo e llogaritur me çmimin 179.60 lekë/litri që është 776,770 lekë, duke sjellë një pagesë tepër prej 39,202 lekë.

Vlefatat e mësipërme janë përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c dhe datë 31.12.2011 neni 4. “Nëse çmimi, gjatë kohës së zbatimit të kontratës..... ndryshon dukshëm, me kërkesë me shkrim të palëve, pasqyron, në faturat periodike të shitjes, çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD” dhe duhet të arkëtohen.

1.2 Niveli i prioritetit.

Vlera e mësipërme në shumën 269,867 lekë ka nivel të ultë prioriteti dhe është me ndikim të paktë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

1.3 Rekomandimi.

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë, administrativë e përmbartimorë në vlerën 269,867 lekë si më poshtë për:

1-Operatorin “E...D...Albania” sh.a. për vlerën 269,867 lekë, e cila rezulton nga mos respektimi i çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturën, bazuar në çmimit referuar bursës REUTERS botuar në buletin e APP, deklaratës doganore SAD, respektivisht: vlerën 29,014 lekë sipas kontratës “Blerje karburant për vitin 2013”, vlerën 201,651 lekë sipas kontratës nr. 492, datë 4.9.2013 dhe vlerën 39,202 lekë sipas kontratës shtesë datë 16.4.2014 përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VIII, pika 2/c dhe datë 31.12.2011 neni 4. “Nëse çmimi, gjatë kohës së zbatimit të kontratës..... ndryshon dukshëm, me kërkesë me shkrim të palëve, pasqyron, në faturat periodike të shitjes, çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD” dhe duhet të arkëtohet.

Menjëherë

2.1 Gjetja nga auditimi.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike rezulton se në situacionet mujore janë paguar zëra punimesh të pareaizuara, të pa pasqyruar në librezën e masave, aktet e kontrollit dhe ditarin e punimeve. Si rrjedhojë janë likuiduar situacione për punë të pakryera të përfituara nga subjektet si më poshtë:

1-Operatorët “N...” sh.p.k & “A...K...2002” sh.p.k në vlerën 982,440 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje Rutinë + Dimërore me Performancë aksi rrugor Korçe – Ersekë 42 km”.

2-Operatorët “A...” sh.p.k & “V...” sh.p.k në vlerën 373,555 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje Rutinë e Dimërore me Performancë rruga K/Boboshticë – Dardhë + Rruga Korçe – Voskopojë 35 km”.

3-Operatori “V...” sh.p.k në vlerën 1,029,266 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje rutinë+dimërore me performancë e aksit rrugor Korçe-Petrushë 25 km”.

4-Operatorët “A...” sh.p.k & “V...” sh.p.k në vlerën 786,563 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje Rutinë e Dimërore me Performancë rruga K/Boboshticë – Dardhë + Rruga Korçe – Voskopojë 35 km”.

5-Operatori “V...” sh.p.k në vlerën 1,153,851 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje Rutinë e Dimërore me Performancë rruga Korçe – Kapshticë 36 km”.

6-Operatori “Sh...” sh.p.k në vlerën 5,445,886 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje rutinë me performancë e aksit rrugor Fier–Seman (Plazh) + Pojan-Apolloni+ Bye Pass Fier - Rrethrotullimi Kolonjë 31 km”.

7-Operatori “E...” sh.p.k në vlerën 2,000,052 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje rutinë me performancë e aksit rrugor Rrogozhinë-Fier 43 km”.

15.3 Niveli i prioritetit.

Vlera e mësipërme në shumën 11,771,613 lekë ka nivel të lartë prioriteti dhe është me ndikim të lartë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

2.3 Rekomandimi.

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, duke ndjekur të gjitha hapat ligjor, administrativ e përmbarimorë në vlerën **11,771,613** lekë si më poshtë për:

1-Operatorët “N... & A.K...2002” sh.p.k në vlerën **982,440** lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje Rutinë + Dimërore me Performancë aksi rrugor Korçë – Ersekë 42 km”.

2-Operatorët “A...&V...” sh.p.k në vlerën **373,555** lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje Rutinë e Dimërore me Performancë rruga K/Boboshticë – Dardhë + Rruga Korçë – Voskopojë 35 km”.

3-Operatorin “V...” sh.p.k në vlerën **1,029,266** lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje rutinë+dimërore me performancë e aksit rrugor Korçë-Petrushë 25 km”.

4-Operatorët “A...&V...” sh.p.k në vlerën **786,563** lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje Rutinë e Dimërore me Performancë rruga K/Boboshticë – Dardhë + Rruga Korçë – Voskopojë 35 km”.

5-Operatorin “Vashtemia” sh.p.k në vlerën **1,153,851** lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje Rutinë e Dimërore me Performancë rruga Korçë – Kapshticë 36 km”.

6-Operatorin “Sh...” sh.p.k në vlerën **5,445,886** lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje rutinë me performancë e aksit rrugor Fier–Seman (Plazh) + Pojan -Apolloni + Bye Pass Fier-Rrethrotullimi Kolonjë 31 km”.

7-Operatorin “E...” sh.p.k në vlerën **2,000,052** lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje rutinë me performancë e aksit rrugor Rrogozhinë-Fier 43 km”.

Menjëherë

C.MASA DISIPLINORE:

a-Në zbatim të nenit 72 pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, pika 3, mbështetur në kreu IV, neni 11, germa “e” dhe “ç”, nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenit 10 të kontratës individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të Drejtorisë Rrugore Rajonale Gjirokastrë, në cilësinë e autoritetit kontraktor, që për shkeljet e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike, në zbatimin e kontratave të furnizimit të mallrave, të fillojë procedurat për marrjen e masave disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për punonjësit si më poshtë:

1. **A.N.**, specialist në sektorin e menaxhimit të kontratave, anëtar i KVO.
2. **S.G.**, specialist në sektorin e menaxhimit të kontratave, anëtar i KVO.
3. **K.K.**, specialist në sektorin e menaxhimit të kontratave, anëtar i KVO, për arsye se:
Nga auditimi i procedurës së prokurimeve janë konstatuar gjetje si më poshtë:

-Gjetja nga auditimi, 5.1.

Nga KVO për prokurimet e zhvilluara nuk janë mbajtur procesverbalet e vlerësimit të procedurave, ofertave të paraqitura për pjesëmarrësit dhe vlerësimin e të gjitha dokumenteve e paraqitura prej tyre ku të pasqyrohen operatorët e kualifikuar dhe ata të skualifikuar sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa i: “Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbalin e prokurimit”, (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Gjetjet nga auditimi 6.1, 7.1, 8.1:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Mirëmbajtje rutinë + dimërore me performancë rruga “K/Dhuvjan-Libohovë + rruga Valare-Çajup” 28 km”, kualifikimi i operatorëve “Argjiro-Building” sh.p.k & “J...-C...” sh.p.k.;

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Mirëmbajtje rutinë + dimërore me performancë aksi rrugor “Vlorë - Palasë” 50 km”, kualifikimi i operatorit “K...G...Konstruksion” sh.p.k.;

-Në tenderin e zhvilluar me objekt Mirëmbajtje rutinë me performancë aksi rrugor “Fier-Rrogozhinë” 43 km”, kualifikimi i operatorit “E...A” sh.p.k. janë në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa ç; “..... komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo që nuk janë me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik....” dhe kanë përgjegjësi anëtarët e KVO, (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 121-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Gjetja nga auditimi 10.1.

Në tenderat e zhvilluar me objekt:

-“Mirëmbajtje rutinë, dimërore me performancë aksi rrugor “Vlorë-Palasë” 50 km”,

-“Mirëmbajtje rutinë me performancë aksi rrugor “Fier-Rrogozhinë” 43 km”,

-“Mirëmbajtje rutinë me performancë aksi rrugor “Levan-Damës 39 km”,

-“Mirëmbajtje rutinë + dimërore me performancë aksi rrugor Korçë-Ersekë 42 km”,

-“Mirëmbajtje rutinë+dimërore me performancë rruga “Korçë Boboshticë-Dardhë” + Korçë-Voskopojë” 35km”,

- në marrëveshjet e bashkëpunimit bashkimi i operatorëve, kanë përcaktuar % e punimeve pa përcaktuar zërat e plotë për secilin operator, pa u përcaktuar elementët konkretë që do të kryejë secili nga operatorët, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreut VII, pika 2, germa a, b: “Para dorëzimit të ofertës, grupi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi”, (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4-L.H., me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

5-M.K., përgjegjëse e Sektorit të Mirëmbajtjes, Financës dhe Shërbimeve, për arsye se:

-Nga auditimi i zbatimit të kontratave të furnizimit janë konstatuar gjetje si më poshtë:

-Gjetja nga auditimi 13.1.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje karburant 2013”, nga llogaritja e furnizimit të likuiduar për subjektin “E...D...Albania” sh.a. rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS datën 10 qershor 2013 si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 1,921,492 lekë për sasinë e gazoilit D1 prej 10,990 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 172.20 lekë/litri që është 1,892,478 lekë duke sjellë një pagesë tepër prej 29,014 lekë.

-Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar për subjektin “E...D...Albania” sh.a. sipas kontratës nr. 492, datë 4.9.2013 rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS datën 5 qershor 2013 si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 4,079,215 lekë për sasinë e gazoilit D1 prej 21,590 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 179.60 lekë/litri që është 3,877,564 lekë duke sjellë një pagesë tepër prej 201,651 lekë.

-Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar për subjektin “E...D...Albania” sh.a. sipas kontratës shtesë datë 16.4.2014 rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS datën 5 qershor 2013 si rrjedhojë edhe

vleftha e likuiduar prej 815,972 lekë për sasinë e gazoilit D1 prej 4,325 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 179.60 lekë/litri që është 776,770 lekë duke sjellë një pagesë tepër prej 39,202 lekë.

Vleftat e mësipërme janë përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c dhe datë 31.12.2011 neni 4. “Nëse çmimi, gjatë kohës së zbatimit të kontratës..... ndryshon dukshëm, me kërkesë me shkrim të palëve, pasqyron, në faturat periodike të shitjes, çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD” dhe duhet të arkëtohen.

-Gjetja nga auditimi 14.1.

Në të gjitha kontratat e furnizimit me karburant nuk janë ngritur komisione dhe nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim të mallit sipas kontratës dhe kërkesave të VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b : “Për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet,.... Autoriteti kontraktor, mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMF nr. 92, datë 29.12.2011, “Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, lista e proceseve të punës për prokurimet me vlerë të lartë, njësia e prokurimit në përgatitjen e dosjes së dokumenteve të tenderit ndër të tjera duhet të jenë kontrata, fatura, raporti për marrjen në dorëzim të mallit fletë hyrja e magazinës”, UMF nr. 33, datë 11.7.2013, “Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42 “Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues”, pika 54 “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore.... financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka bashkëlidhur dokumentacioni justifikues që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës”, (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b-Në zbatim ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenit 10 të kontratës individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të Drejtorisë Rrugore Rajonale Gjirokastrë, në cilësinë e autoritetit kontraktor, që për shkeljet e konstatuara në zbatimin dhe mbikëqyrjen e kontratave të punimeve, të fillojë procedurat për marrjen e masave disiplinore:

“vërejtje” deri në “zqijdhjen e kontratës së punës”, duke gjykuar në bazë të përgjegjësisë rast mbas rasti, për punonjësit si më poshtë në cilësinë e mbikëqyrësit:

6-Ing. A.H. me licencë mbikëqyrje punimesh MK nr. 2091, dt. 18.8.2011 punonjës i Drejtorisë Rrugore Rajonale Gjirokastrë.

7-Ing. L.M. me licencë mbikëqyrje punimesh MK nr. 1579, dt. 21.07.2008 punonjës i Drejtorisë Rrugore Rajonale Gjirokastrë.

8-Ing. F.GJ. me licencë mbikëqyrje punimesh MK nr. 0020, dt. 01.7.2002, punonjës i Drejtorisë Rrugore Rajonale Gjirokastrë.

9-Ing. A.V. me licencë mbikëqyrje punimesh MK nr. 0759, dt. 26.5.2005, punonjës i Drejtorisë Rrugore Rajonale Gjirokastrë.

10-Ing. XH.SH. me licencë mbikëqyrje punimesh MK nr. 2491, dt. 01.7.2013, punonjëse e Drejtorisë Rrugore Rajonale Gjirokastrë.

11-Ing. B.S. me licencë mbikëqyrje punimesh MK nr. 0102, punonjëse e Drejtorisë Rrugore Rajonale Gjirokastrë, për arsye se:

-Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit për kontratat e shërbimeve ku personat e mësipërm kanë qenë mbikëqyrës të punimeve të ndërtimit rezultoi si më poshtë:

-Gjetja nga auditimi 15.1.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike rezulton se në situacionet mujore janë paguar zëra punimesh të pa realizuara, zëra këto të cilët nuk janë pasqyruar në librezën e masave, aktet e kontrollit dhe ditarin e punimeve. Si rrjedhojë janë likuiduar situacione për punë të pakryera të përfituara nga subjektet si më poshtë:

1-Operatorët "N..." sh.p.k & "A...2002" sh.p.k në vlerën 982,440 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin "Mirëmbajtje Rutinë + Dimërore me Performancë aksi rrugor Korçe – Ersekë 42 km".

2-Operatorët "A..." sh.p.k & "V..." sh.p.k në vlerën 373,555 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin "Mirëmbajtje Rutinë e Dimërore me Performancë rruga K/Boboshticë – Dardhë + Rruga Korçe – Voskopojë 35 km".

3-Operatori "V..." sh.p.k në vlerën 1,029,266 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin "Mirëmbajtje rutinë+dimërore me performancë e aksit rrugor Korçë-Petrushë 25 km".

4-Operatorët "A..." sh.p.k & "V..." sh.p.k në vlerën 786,563 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin "Mirëmbajtje Rutinë e Dimërore me Performancë rruga K/Boboshticë – Dardhë + Rruga Korçe – Voskopojë 35 km".

5-Operatori "V..." sh.p.k në vlerën 1,153,851 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin "Mirëmbajtje Rutinë e Dimërore me Performancë rruga Korçë – Kapshticë 36 km".

6-Operatori "Shendelli" sh.p.k në vlerën 5,445,886 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin "Mirëmbajtje rutinë me performancë e aksit rrugor Fier–Seman (Plazh) + Pojan-Apolloni+ Bye Pass Fier - Rrethrotullimi Kolonjë 31 km".

7-Operatori "E...A" sh.p.k në vlerën 2,000,052 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin "Mirëmbajtje rutinë me performancë e aksit rrugor Rrogozhinë-Fier 43 km".

-Gjetja nga auditimi 16.1

Nga auditimi i zbatimit të kontratave, dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, situacionet mujore, librezat e masave, aktet e kontrollit dhe ditarin e punimeve konstatohet se:

1-Nuk ka patur një korrespondencë të rregullt bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktor, mbikëqyrësit të punimeve dhe operatorëve ekonomik në zbatimin e kontratave të shërbimit.

2-Për situacionet e paraqitura nga operatorët, në shumë raste nuk janë kryer kontrole nga mbikëqyrësi dhe nuk ka dokumente shoqëruese për të vërtetuar saktësinë dhe vërtetësinë e tyre.

3-Janë konstatuar mangësi dhe shkelje në kontrollin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të punës dhe shërbimeve lidhur me zbatimin e kontratave si:

a-Nga Kontraktori i shërbimeve nuk janë kryer inspektime dhe prova 1 herë në javë (për rrugë kombëtare të asfaltuara) dhe nuk janë dorëzuar raportet e inspektimit të punimeve një herë në dy javë (një të hënë po e një jo), si përcaktohet në kontratat në kapitullin A. 3 Inspektimet dhe Provat si dhe A. 8 Detyrat Administrative të Kontraktorit.

b-Në disa dosje teknike nuk rezulton të jetë kryer asnjë inspektim informal nga ana e kontraktorit dhe mbikëqyrësve të punimeve mbi Nivelet e Cilësisë së Shërbimit duke mos u përmbushur në këtë mënyrë edhe detyra kryesore nga ana e Menaxherit të Projektit ajo e kontrollit të projektit në tërësi sipas kushteve të kontratës si dhe detyrimeve ligjore si mbikëqyrës i punimeve.

c-Nga Kontraktori i shërbimeve nuk është krijuar Njësia e Vetë-Kontrollit sipas kontratave, kapitullit A. 3, paragrafi i katërt i kushteve të kontratës.

d-Nga autoriteti kontraktor janë likuiduar situacione për punë të pakryera të cilat nuk rezultojnë në dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, librezat e masave, aktet e kontrollit dhe ditarin e punimeve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratat e hartuara, ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", neni 7, UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Kreu I, pika 1 dhe me UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë

15.2.2001 të këshillit të ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar Pikat 3.2 dhe 3.3.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Bexhet Zeqiri, Halil Isufi, Rajmondi Koçi, Rezart Golemaj dhe Jonild Hoxhaj më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT